

Bislmi: Kosova u pajtua me propozimin e BE-së për dinarin, Serbia kërkoi kohë shtesë



Faqe 2

Vuçiq kërkon formimin e ekipit për lobim kundër Kosovës në KiE



Faqe 3

Blinken: Ukraina do të bëhet anëtare e NATO-s



Faqe 6

Kosova lufton por nuk ia del ndaj Polonisë



Faqe 18

e premtë • 5 prill 2024

Numri 9600

KOHA DITORE

www.koha.net



AUTORITETET E RENDIT DHE TË DREJTËSISË NDËRMARRIN VEPRIME RRETH PASURISË SË ORGANIZATORIT TË SULMIT NË BANJSKË

Konfiskohet pasuria multimilionëshe e Radoiçiqit

Ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka njoftuar të enjten se Radoiçiqit i janë konfiskuar më shumë se 30 automjete, një vilë, një banesë, një restorant e pasuri të tjera teksa ka bërë të ditur se 31 mjete transportuese të kapura në Banjškë, pas një vendimi të gjykatës për konfiskim, i janë dhënë në shfrytëzim Policisë së Kosovës

Valbona Bytyqi

PRISHTINË, 4 PRILL – Më shumë se 30 automjete, një vilë, një banesë, një restorant e pasuri të tjera i janë konfiskuar udhëheqësit të grupit të armatosur serb që e organizoi sulmin e fundshtatorit të vitit të shkuar në Banjškë të Zveçanit, Milan Radoiçiq.

Ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka njoftuar të enjten se Radoiçiqit i është konfiskuar pasuri në vlerë multimilionëshe, teksa ka bërë të ditur se 31 mjete transportuese të kapura në Banjškë, pas një vendimi të gjykatës për konfiskim, i janë dhënë në shfrytëzim Policisë së Kosovës.

“Ju informoj se para pak kohësh, Agjencia për Konfiskim dhe Menaxhim të Pasurisë së Sekuestruar, ka pranuar vendimin e gjykatës që ndërlidhet me konfiskimin e 31 mjeteve transportuese, të cilat ndërlidhen me rastin që po hetohet nga Prokuroria Speciale, pra rastin Banjška, pra sulmin terrorist në Republikën e Kosovës ku si pasojë është vrarë edhe një polic. Pra, janë 31 mjete transportuese, të cilat janë të konfiskuara dhe të cilat Ministria e Drejtësisë ia ka dhënë në shfrytëzim Policisë së Republikës së Kosovës për nevojat të cilat i ka, pra për shfrytëzim të këtyre mjeteve transportuese,” ka thënë Haxhiu në një deklaram për media në Kuvend.

Një ditë më parë, Agjencia për Administrimin e Pasurisë së

Sekuestruar e Konfiskuar ka nisur zbatimin e urdhrin ndalues edhe për pronat e tjera të Radoiçiqit.

Krahas vilës së tij, të enjten janë konfiskuar edhe pronat e tjera të Radoiçiqit, i cili është duke u strehuar në Serbi. Në mesin pasurive të konfiskuara është edhe restoranti “Grey” dhe banesa e tij, të cilat ndodhen në të njëjtin objekt banesor në Mitrovicë të Veriut.

Haxhiu ka thënë se janë duke vazhduar procedurat drejt menaxhimit të pasurisë së sekuestruar të Radoiçiqit nga institucionet e Kosovës.

“Gjatë këtyre ditëve ne kemi nisur të zbatojmë urdhrin e gjykatës, gjegjësisht aktvendimin e Gjykatës të Apelit, Departamentit Special që ndërlidhet me menaxhimin e pasurisë së sekuestruar dhe me këtë rast bëhet fjalë për vilën që konsiderohej e kryekriminelit Milan Radoiçiq, restorant, banesë në emër të bashkëshortes dhe tash po bëhet puna për menaxhimin e kësaj pasurie së sekuestruar deri në përfundim të procedurës në institucionet e drejtësisë. Këto do të monitorohen nga Policia e Kosovës nga afër dhe po ashtu me kamera të sigurisë për shkaqe që mund të dihen”, ka thënë ajo.

Haxhiu ka publikuar listën e pasurisë së konfiskuar, në të cilën përfshihen edhe vetura, motorë dhe një barkë. Ajo ka thënë se Radoiçiqi është pasuar nëpërmjet krimit.

vijon në faqen e dytë



Foto: Alban Bujari

Prishtinë, 4 prill – Me seancë solemne deputetët e Kuvendit e kanë shënuar të enjten 25-vjetorin e Betejës së Koshares. Presidentja Vjosa Osmani ka thënë se luftëtarët e Betejës së Koshares e pasqyrojnë vetëmohimin e popullit të Kosovës për t'i dhënë gjithçka atdheut. Ajo ka theksuar se në Betejën e Koshares, sikurse edhe në kapitujt e tjerë të historisë së Kosovës, përmbledhin guximi, sakrificën dhe vendosmërinë e popullit për liri. Kryeparlamentari Glauk Konjufca ka shprehur qëndrimin se rruga për pavarësi e për shtetësi e Kosovës është rezultat i heroizmit të luftëtarëve. E kryeministri Albin Kurti ka thënë se lufta për shembjen e kufirit, pos rëndësisë strategjike e operative, e ka pasur edhe atë historike e kombëtare

ME PROTESTA PARA REKTORATIT ËSHTË PËRCJELLË INTERVISTIMI I STUDENTEVE DHE PROFESORIT XHEVAT KRASNIQI, I DENONCUAR PËR NGACMIM SEKSUAL

Këshilli i Etikës interviston studentet, s'i pyet për ngacmim seksual

Majlinda Ibrahim

PRISHTINË, 4 PRILL - Me tri javë vonesë nga ajo që e parasheh rregullorja, Këshilli i Etikës i ka intervistuar palët të enjten, në rastin e denoncimit të 27 studenteve për ngacmim seksual ndaj profesorit Xhevat Krasniqi. Rregullorja për masat dhe procedurat disiplinore ndaj stafit akademik, parasheh që palët të intervistohen brenda pesë ditëve pas paraqitjes së shkeljes.

“Intervistimi të bëhet sa më shpejt, sa më shpejt që është e mundur pas

paraqitjes së shkeljes së dyshuar, por jo më vonë se pesë ditë pune, duke siguruar se shkelësi i dyshuar është njoftuar dy ditë pune më herët”, shkruan në nenin e 7 të rregullores.

Tri nga studentet që u intervistuan të enjten, në kushte anonimite kanë thënë se anëtarët e Këshillit nuk i dëgjuan rrefimet e tyre për ngacmim seksual.

“Patëm një eksperiencë jo të mirë duke filluar prej faktit që nuk më lejuan të shprehem emocionalisht se si jam ndier kur më ka ngacmuar

profesori Xhevat Krasniqi. Nuk dëshironin ta dëgjonin rastin tim për ngacmim, ata u fokusuan më shumë për pjesën e mosvlerësimit, e pjesën e ngacmimit as nuk dëshironin ta dëgjonin”, ka treguar njëra nga studentet në kushte anonimite.

Studentet u intervistuan nga 10 minuta veç e veç nga katër anëtarët e Këshillit të Etikës: Zet Morina, Skender Muji, Arben Hajdari e Rrezeart Galica. E profesori Krasniqi qëndroi 45 minuta brenda në intervistim. Përdërisa brenda zhvillohej intervistimi, studentët e Lëviz-

jes Feministe Studentore protestonin para Rektoratit për të dytën ditë radhazi me kërkesën që të përjashtohet profesori Krasniqi dhe të shkarkohen anëtarët e Këshillit.

Pas përfundimit të intervistimit, studentët protestues ia bllokuan daljen anëtarëve të Këshillit për 40 minuta. E për t'ia mundësuar daljen u nevojiti ndërhyrja e policëve, të cilët pas bashkëbisedimit me protestuesit, i ndihmuan anëtarët e Këshillit të dalin jashtë objektit.

vijon në faqen e pestë

Kandidatët ngelin në test, dështon konkursi për drejtor të Bibliotekës



Është bërë traditë tashmë që asnjëri konkurs për drejtor ia udhëheqës institucionesh kulturore e të trashëgimisë të mos shkrepe më të parën. I radhës, ai për drejtor të Bibliotekës Kombëtare të Kosovës, “Pjetër Bogdani”. Trembëdhjetë veta ia kishin mësyre kësaj pozite, dhjetë ishin kualifikuar për fazën e radhës, shtatë kishin hyrë në testin me shkrim, asnjëri nuk...

Faqe 13